FEDERATA SHQIPTARE E JUDOS
ALBANIAN JUDO FEDERATION

Address: Rr."Grigor Heba 100"
Parku Olimpik
Tirana / ALBANIA
albjudofederation@hotmail.com

Nr. Prot

Tirane 26/03/2026

# RREGULLORE AKTIVITETESH

## Per zhvillimin e aktiviteteve sportive kombetare

### Komiteti Drejtues i FSHJ me date 26/03/2026 miratoi keto rregulla

Aktivitetet sportive federata i zhvillon sipas standarteve te federates boterore (IJF) dhe ne perputhje me Ligjin e Sportit, Statutin dhe rregulloret e FSHJ.

1. Viti kalendarik sportiv fillon ne 1 Janar deri ne 31 Dhjetor te cdo viti.

2. Licensimet per klube, shoqata dhe shoqeri do te ben nga data 1 Janar deri ne 31 Janar te cdo viti kalendarik sportiv.
   - Nuk lejohen transferimet dhe levizjet brenda nje viti kalendarik nga nje ekip ne tjetrin.
   - Lejohen licensime te reja dhe anetare te rinj te klubeve dhe shoqatave, gjithmone me miratim nga federata.
   - Lejohen te licensohen Shqipetare qe ushtrojne sportin e Judos ne Europe.
   - Ndalohen te futen sportiste ne aktivitete sportive te Federates, te pa licensuar dhe pa vizita mjekesore.
   - Ne aktivitetet zytare te FSHJ nuk lejohen te marrin pjese ne gara brenda dhe jashte vendi: sportistet qe aktivizohen dhe garojne ne sporte te tjera ( qofshin keta dhe te licensuar).
   - Ne aktivitete zyrtare te FSHJ nuk lejohen te marrin pjese sportiste qe jane ne sistemin Judobase dhe konkurojne dhe perfaqesojne shtete te tjera ne aktivitete nderkombtare ose marrin pjese ne aktivitete zyrtare te nje shteti tjeter. Per licensimin ne FSHJ do te zbatohet rregullorja e IJF.

3. Per peshim ne aktivitete do te zbatohet rregullorja e IJF.
   - Per turne te vecante, do te kete vendime te vecanta qe do te komunikohen para aktivitetit.
   - Ne qofte se nuk ka sistem elektronik per hedhjen e shortit, do te behet hedhja e shortit me terheqje numrash nga traineret.

4. Ne qofte se ka vetem nje sportis te peshe, kjo kategori gare nuk zhvillohet dhe nuk klasifikohet fare.
   - Kur jane dy persona, personi i dyte nuk klasifikohet dhe nuk fiton as diplome, as medalje.
   - Kur ne kategori jane 3 persona, ndeshjet do te zhvillohen me sistem rrethi. Ne qofte se vendi i trete ka 2 humbje, nuk klasifikohet dhe nuk perfiton medalje ne diplome.
   - Per te mbushur tabelen e ndeshjeve, ne turin eleminator, ndeshja e pare fillon me numrin 1. Te tjeret do te kalojne direkt nese nuk kane kundershtare.

Address: Rr."Grigor Heba 100"
Parku Olimpik
Tirana / ALBANIA
albjudofederation@hotmail.com


5. Duhet te respektohet Fair Play dhe kodi i etikes. Traineri mban pergjegjsi per sjelljen e sportisteve.

6. Trajenrit dhe sportistit i ndalohet te afrohet ne tavolinen e gjyqtarise dhe kameras. Ankesa behet tek Kryegjyqtari i garave.

7. Kjo rregullore eshte e vlefshme per aktivitete zyrtare te FSHJ per moshat 12 vjec e larte.

8. Neqoftese konstatohen dhe ka informacion te pikave te mesiperme qe nuk respektohen menjehere mblidhet Komisioni i Gjyqtarise dhe merr vendim per secilen nga pikat.
   Ky vendim me pas shqyrtohet ne Komitetin Drejtues ne mbledhjen me te afert te saj.

Bashkangjitur ndodhet dhe formulari i IJF i cili percakton qarte peshat dhe kategorite per SENIOR, JUNIOR, KADET, 13 -14 vjec, 10- 12 vjec.

| Presidenti i FSHJ | Anetar te KE | Sekretar i Pergjithshem |
|---|---|---|
| Drin Shkreta | Enrik Koca | Labo Çapo |
| | Monked Lameti | |
| | Maksim Kenti | |
| | Fatlime Hasani | |